





Indeksi

Përmbajtja e projektit	4
Kush është Haré Residence	6
Lokacioni i përsosur	11
Parku urban	13
Mirëmbajtja	14
Lobby	16
Korridoret	17
Apartamentet	20
Arkitektura moderne	23
Vendparkimet	27
Fasada	28
Tarracat e gjelbra	33
Izolimet	34
Panelet solare	38
Hapësirat e gjelbra	40
Sistemi i mbeturinave	42
Pompat termike	44
Ndriçimi	47
Qendra për komunitetin	48
Kopshti për fëmijë	50
Wellness	52
Spa	55
Pishina	56
Sauna	59
Palestra	61
Hapësirë për joga	62
Furra	67
Marketi	68

Objekte banimi

7

Njësi banesore

162

Njësi afariste

20

Vendparkime

443

Sipërfaqet
e gjelbra

1.28ha

Kush është Haré Residence?

Në qiellin e Prishtinës, Haré Residence shpaloset me një madhështi që tërheq vëmendjen, duke krijuar një atmosferë të re dhe të veçantë për qytetin. Me lartësinë dhe elegancën e tij, ky kompleks i jashtëzakonshëm është një simbol i modernitetit dhe estetikës. Haré Residence ka lindur nga pasioni i një ekipi të përkushtuar profesionistësh, të cilët vijnë nga disiplina të ndryshme. Çdo detaj është menduar dhe realizuar me kujdes, duke e shndërruar atë që fillimisht ishte një vizion, në një realitet të prekshëm, ku jetesa moderne dhe kushtet e shkëlqyera janë në harmoni perfekte.



Parku Rezidencial



Logjia Amerikane



Shkolla
Filllore



Lokacion i përsosur

Toka ku është e ndërtuar Haré Residence ka një pozicion strategjik që siguron pamje dhe ndriçim natyral gjatë gjithë ditës. Imagjinoni: çdo mëngjes, dielli lind ngadalë dhe mbush hapësirat tuaja me energji pozitive, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe të bukur që ju shoqëron gjatë gjithë ditës.

Kjo mundësi e jashtëzakonshme e pozicionimit në jug-lindje, që i lejon hapësirave të përfitojnë në maksimum nga dielli, sjell një ngrohtësi të këndshme dhe ndihmon për të ruajtur një ambient të shëndetshëm. Me ajër të freskët dhe dritë natyrale që përshkon çdo kënd të shtëpisë suaj, ky vend jo vetëm që është i përshtatshëm për jetesë, por gjithashtu krijon një lidhje të veçantë me natyrën.

Vendndodhja strategjike

Pozicioni i kompleksit është ideal, duke u ofruar banorëve mundësinë për të pasur qasje të lehtë në shkolla, spitale, qendra tregtare, te liqeni, në park dhe institucione publike. Ky vend është i përshtatshëm për ata që kërkojnë komoditet dhe qasje të shpejtë në shërbime dhe aktivitete të përditshme.



Parku urban

Parku urban ofron një hapësirë të shkëlqyer për relaks dhe aktivitet fizik, duke sjellë një ekuilibër të bukur mes natyrës dhe jetës urbane. Në këtë park, banorët mund të shijojnë një shëtitore të bukur, e cila lidh pjesë të ndryshme të kompleksit dhe ofron mundësi për ecje, biseda, dhe momente qetësie. Gjithashtu, parku funksionon si një hapësirë e përbashkët mes banesave, ku komuniteti mund të mblidhet, të ndërveprojë dhe të krijojë lidhje më të forta, duke u bërë një vend ideal për socializim dhe aktivitete të përditshme.

Ambientet e Haré Residence do të mirëmbahen me kujdes dhe profesionalizëm nga ekipi i Haré Residence.

Mirëmbajtje e vazhdueshme për një mjedis të qëndrueshëm

Për të garantuar një jetëgjatësi dhe cilësi të lartë të jetesës, mirëmbajtja e rregullt e objekteve dhe hapësirave të përbashkëta është thelbësore.

- ✓ **Hapësirat e gjelbra** mirëmbahen me kujdes të veçantë për të ruajtur freskinë dhe bukurinë e natyrës në çdo sezon.
- ✓ **Objektet banesore** i nënshtrohen kontrolleve dhe ndërhyrjeve të nevojshme për të ruajtur sigurinë, funksionalitetin dhe estetikën e tyre.
- ✓ **Pastërtia dhe higjiena** janë prioritet për të krijuar një ambient të pastër dhe të këndshëm për të gjithë banorët.
- ✓ **Siguria në kompleks** është e garantuar 24 orë në ditë, duke ofruar një ambient të sigurt dhe të qetë për të gjithë banorët.
- ✓ **Mirëmbajtja e infrastrukturës** realizohet në mënyrë të rregullt për të ruajtur funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e të gjithë elementeve të kompleksit.
- ✓ **Mirëmbajtja e ndriçimit** është një prioritet, për të garantuar që çdo hapësirë të jetë e ndriçuar siç duhet.
- ✓ **Mirëmbajtja**, si pjesë e kompleksit dhe administratës, siguron funksionimin e vazhdueshëm të objekteve dhe hapësirave të përbashkëta.





Lobby

Një hapësirë që frymëzon qetësi, ku çdo detaj është krijuar për të ofruar një përshtypje pozitive dhe një ndjesi të vërtetë mirëseardhjeje. Çdo hyrje disponon dy ashensorë për komoditet maksimal, ndërsa ndriçimi dhe ajrosja natyrale kontribuojnë në krijimin e një atmosfere freskuese dhe të këndshme.

Korridoret

Korridoret e Haré Residence janë të gjera dhe të hapura, duke i dhënë çdo banori hapësirën e nevojshme për të lëvizur me lehtësi dhe pa ndjesinë e ngarkesës. Qasjet në ndërtesa mbikëqyren nga një sistem dixhital modern, që siguron një kontroll të avancuar të hyrjeve. Ky sistem ka si qëllim të krijojë një atmosferë të qetë, pa shqetësime, dhe t'u ofrojë banorëve një ndjesi sigurie dhe privatësie.

Jeto si mbi re!

Në Haré Residence, jeta është si një re e butë që ju mbështjell me ngrohtësi. Çdo mëngjes nis me dritën e butë që shpërndahehet nëpër dhomat tuaja, dhe çdo natë mbyllet me hënën që ju sjellë harmoni e Haré.



Apartamentet

Kompleksi Haré Residence ofron **162 njësi banesore**, të shpërndara në **7 objekte banimi**, ku çdo apartament është projektuar me kujdes për të ofruar një përvojë jetese të rafinuar dhe të qetë. Me një dizajn modern dhe hapësira të bollshme, secili apartament është krijuar për të siguruar më shumë se një vend për të jetuar. Dhomat e gjumit, korridoret e gjerë dhe kuzhinat moderne janë të lidhura me dhomat e ndjenjës dhe hapësirat për ngrënie, duke ofruar një përvojë të rehatshme dhe praktike. Ky kompleks është ideal për ata që kërkojnë një jetesë pa kompromise, ku çdo element është menduar që të ofrojë harmoni dhe cilësi në çdo moment të ditës.

Pozicionim i përsosur

Drejtimi i kompleksit nga lindja i ndihmon hapësirave të përfitojnë maksimalisht nga drita e diellit, sidomos gjatë mëngjesit deri në mesditë, kur dielli ndriçon hapësirat në mënyrë të natyrshme dhe plot energji. Ky orientim jo vetëm që sjell një ngrohtësi të këndshme, por gjithashtu rrit mirëqenien duke ofruar mundësinë për ajër të freskët, dhe duke bërë që gjithsecili të ndjehet më afër natyrës. Përveç kësaj, ndriçimi i bollshëm natyral është ideal për ruajtjen e energjisë dhe për krijimin e një ambienti të shëndetshëm dhe të relaksuar. Në veçanti, 95% e banesave kanë qasje direkte në diellosje gjatë ditës, duke garantuar një ambient plot dritë dhe energji pozitive. Nivelet e pamjaftueshme të dritës natyrore në hapësira banimi mund të rrisin nivelet e stresit dhe ankthit. Studimet tregojnë se një mjedis i shëndetshëm dhe i këndshëm mund të bëjë më shumë sesa të përmirësojë humorin tuaj – ai ndikon gjithashtu në sistemin tuaj imunitar dhe shëndetin fizik.

Arkitektura moderne dhe dizajni unik

Kompleksi është projektuar me një stil arkitektonik modern dhe një dizajn unik, duke marrë frymëzim kryesisht nga konceptet perëndimore të arkitekturës së shekullit 21, me ndikime të forta nga shprehitë estetike dhe praktike të Evropës. Stili përfshin elemente të arkitekturës moderne me nuanca të minimalizmit, të cilat ofrojnë një elegancë të rafinuar dhe një ndjesi hapësirash të pastra dhe të bollshme.





Vendparkimet

Janë të siguruar 443 vendparkime, prej të cilave 54 janë të dedikuara për afarizëm, duke eliminuar çdo shqetësim për parkimin në rrugë dhe duke ju kursyer kohë dhe shpenzime të vazhdueshme për gjetjen e një vendi. Përveç hapësirave të veçanta për banorët, janë parashikuar gjithashtu zona për parkimin e automjeteve të mysafirëve, duke ofruar komoditet dhe lehtësi për të gjithë, në çdo kohë.

Çdo njësi banesore i ka nga dy vendparkime!

Fasada

Muret e jashtme të ndërtesave do të ndërtohen me teknologji moderne dhe sisteme bashkëkohore, duke përdorur një fasadë ventiluese për mbulimin e jashtëm. Ky tip fasade ofron izolim të shkëlqyer termik dhe akustik, duke siguruar një ambient të rehatshëm dhe efikas gjatë gjithë vitit. Përveç avantazheve praktike, fasada e ventiluar i jep ndërtesës një estetikë të sofistikuar, duke ruajtur temperaturën ideale brenda hapësirave të banimit dhe minimizuar humbjet e energjisë. Fasada do të jetë e mbuluar me gur natyror travertin 2 cm, duke ofruar një pamje elegante dhe të qëndrueshme. Po ashtu, ndriçimi profesional i fasadës thekson bukurinë e materialeve dhe krijon një atmosferë të paharrueshme, duke e bërë ndërtesën tërheqëse gjatë gjithë ditës dhe natës. Kjo teknologji inovative lejon qarkullimin e ajrit mes shtresave të fasadës, duke reduktuar mbinxehjen në verë dhe ruajtur ngrohtësinë në dimër. Një zgjidhje e zgjuar për një jetë më të rehatshme.







Tarracat e gjelbra

Në brendësi të kompleksit Haré Residence ofrohen apartamente me tarraca të gjelbra, duke sjellë një ambient të veçantë për pushim dhe relaksim. Ky oborr i gjelbër i çdo banese është një hapësirë ideale për të kaluar momente të qeta, për të shijuar ajrin e pastër dhe natyrën që ju rrethon. Këto tarraca janë projektuar për të krijuar një atmosferë të ngrohtë, ku mund të kaloni pasdite të këndshme me familjen, miqtë apo thjesht për të shijuar një kafe të ngrohtë, ose edhe një gotë ujë.

Izolimet në Haré Residence

Bashkëpunimi me SOPREMA

Haré Residence, përdor izolime të avancuara nga SOPREMA, një lider global në hidroizolim, izolim termik dhe akustik. Me mbi 100 vjet eksperiencë, SOPREMA ofron produkte inovative dhe ekologjike për performancë të lartë dhe qëndrueshmëri. SOPREMA ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh për izolim dhe hidroizolim, duke përfshirë produktet për çati, mure, tarraca, bodrume dhe inxhinieri civile. Këtu janë llojet kryesore të izolimeve që SOPREMA kryen:

Hidroizolim - Membrana të modifikuara me SBS dhe APP për çati, tarraca dhe sipërfaqe të tjera. Izolim Termik - Lesh guri & lesh xhami – Materiale izoluese për të mbrojtur nga nxehtësia dhe zhurmat.

XPS & EPS (Polistiren i Ekstruduar/ i Zgjeruar) – Izolim për fasada, dysheme dhe tarraca të rrafshëta.


Izolim Akustik - Sisteme për zbutjen e zhurmave në dysheme, mure dhe tavane.

Membrana speciale - akustike për të reduktuar përhapjen e tingujve në ambiente banimi dhe industriale.

Gjelbërim dhe qëndrueshmëri - Sisteme për çati të gjelbra & zgjidhje për kopshtet e varura dhe rritjen e bimësisë në çati.

Membrana kundër rrënjëve – Mbrojtje për strukturat e hidroizolimit nga depërtimi i rrënjëve të bimëve.

SOPREMA është një lider në treg për izolim inovativ dhe ekologjik, duke ofruar produkte të qëndrueshme me performancë të lartë.







######

Hapësira e

Në mes të ndërtesave, parqet dhe kopshtet e kuruara me kujdes krijojnë një ambient natyror, ku mund të relaksoheni dhe të shijoni momente të bukura me familjen, vetë, apo me të dashurit tuaj.

Në Haré Residence, hapësirat e gjelbra janë më shumë sesa një dekorim estetik – ato janë një investim në shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Këto zona të gjelbra ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për t'u relaksuar dhe për t'u ndjerë më afër natyrës, duke ulur nivelin e stresit dhe duke rritur energjinë pozitive. Përveç kësaj, këto hapësira janë të krijuara për të stimuluar aktivitetin fizik, për të organizuar aktivitete sociale, si piknikë ose ngjarje që bëjnë bashkë komunitetin.

Studimet kanë treguar se kalimi i kohës në ambiente të gjelbra ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes emocionale, ngritjen e përqëndrimit dhe ngritjen e humorit. Pavarësisht nëse jeni duke bërë një shëtitje të qetë në kopsht, duke lexuar një libër në një kënd të qetë, apo duke organizuar një ngjarje të vogël sociale, hapësirat e gjelbra të Haré Residence janë vendi ideal për të rigjeneruar trupin dhe mendjen tuaj.



Sistemi *Kapella* për mbledhjen e mbeturinave

Në Haré Residence, përdoret sistemi i avancuar i mbledhjes së mbeturinave Kapella Full Automatic Garbage Chute System, që e bën procesin e hedhjes së mbeturinave të thjeshtë, efikas dhe të pastër. Ky sistem automatik lidh katet e ndërtesës me një hapësirë të centralizuar për mbledhjen e mbeturinave. Banorët mund të hedhin mbeturinat në hapësirat përkatëse të çdo kati pa pasur nevojë për transport ose manipulim manual. Pas hedhjes, mbeturinat udhëtojnë nëpër një tub të integruar drejt një depozite qendrore. Ky sistem ndihmon në ruajtjen e pastërtisë dhe eliminon aromat e padëshiruara, duke krijuar një ambient më të pastër dhe më të rehatshëm për të gjithë banorët.




Pompa termike HISENSE

Zgjidhja më e avancuar për ngrohje dhe ftohje

Në Haré Residence, implementohet një teknologji e avancuar për ngrohje dhe ftohje me pompat termike HISENSE, duke garantuar komoditet të përhershëm gjatë gjithë vitit dhe efikasitet maksimal të energjisë. Ky sistem siguron temperaturë të përshtatshme në çdo stinë.

Me rrjetin e ngrohjes në dysHEME, do të mund të përjetoni një shpërndarje të barabartë të ngrohtësisë në çdo hapësirë, duke krijuar një ambient të rehatshëm dhe të ngrohtë. Menaxhimi i temperaturës bëhet përmes termostateve profesionale, duke ofruar mundësinë e kontrollit të personalizuar për çdo dhomë, ndërkohë që ndihmon në reduktimin e kostove të energjisë.

Zgjedhja e pompeve termike HISENSE është një investim në cilësi dhe efikasitet, duke kontribuar gjithashtu në një të ardhme më të gjelbër për mjedisin tuaj.





Ndriçimi

Punimet elektrike në këtë projekt do të realizohen me produkte nga brendet e njohura **GIRA, LINEA LIGHT** dhe **SIEMENS**.

GIRA ofron sisteme inteligjente për menaxhimin e ndriçimit, ngrohjes dhe pajisjeve shtëpiake, duke siguruar fleksibilitet dhe efikasitet në energji. **LINEA LIGHT** sjell pajisje ndriçimi inovative me fokus në qëndrueshmëri dhe dizajn modern, ndërsa **SIEMENS** ofron pajisje dhe shërbime për optimizimin e performancës elektrike dhe sigurinë e sistemeve. Këto marka do të sigurojnë cilësi për të garantuar një funksionim të shkëlqyer të të gjithë sistemit elektrik.

Qendra për komunitetin

Qendra për Komunitetin është një hapësirë e gjallë dhe gjithëpërfshirëse, ku banorët mund të shijojnë momente argëtimi dhe relaksi. E pajisur me ambiente të përshtatshme për lojëra të ndryshme – nga tavolinat e pingpongut dhe lojërat e tavolinës, deri te zonat e dedikuara për aktivitete në grup – kjo qendër ofron një vendtakim të përkryer për të gjitha moshat.

Kjo hapësirë prej 270,90 m2 është krijuar për të nxitur ndjenjën e përkatësisë, duke i ofruar komunitetit mundësinë për të ndërtuar lidhje të reja, për të ndarë përvoja dhe për të kaluar kohë cilësore së bashku.



Kopshti i fëmijëve

Kopshti i fëmijëve brenda kompleksit është një hapësirë e veçantë që ofron mundësi të pafundme për zhvillimin e kreativitetit dhe imagjinatës së fëmijëve. Ky mjedis i siguron atyre mundësinë të kalojnë momente të gëzuara dhe argëtuese me shokët e tyre, përmes aktiviteteve mësimore dhe lojërave edukative. Kopshti është projektuar për t'i mbështetur fëmijët në aspekte të ndryshme, si zhvillimi social, motorik dhe emocional.

Me një staf të kualifikuar dhe një qasje edukative të plotë, kopshti krijon një ambient të ngrohtë dhe mbështetës. Ky është një vend ku fëmijët mund të përgatiten për fazat e ardhshme të arsimit, duke ndjekur një program të menduar me kujdes për t'iu përshtatur nevojave të tyre.



Wellness

Brenda Haré Residence, Wellness nuk është vetëm një koncept, por një mënyrë jetese. Hapësirat e dedikuara për të janë krijuar për të ofruar një përvojë relaksuese dhe rigjeneruese për banorët, ku qetësia, ekuilibri dhe kujdesi ndaj vetes janë në qendër të vëmendjes.

Me ambiente të përkushtuara për joga, meditim dhe aktivitete të tjera që përmirësojnë shëndetin mendor dhe fizik, këto hapësira ofrojnë një arratisje të përditshme nga ritmi i shpejtë urban.





SPA

Në SPA-në brenda kompleksit, çdo element është i dizajnuar për të krijuar një ambient të përsosur relaksimi dhe rigjenerimi. Masazhet e specializuara ofrojnë lehtësim nga tensionet dhe stresi i përditshëm, ndërsa saunat e ngrohta ndihmojnë në rifitimin e qetësisë dhe ekuilibrit, duke kontribuar në një ndjesi thelbësore mirëqenieje për trupin dhe mendjen.

Pishina

Pse të mos e shfrytëzojmë një pishinë pas një dite të mbushur me shqetësime?


Pishina e brendshme në Haré Residence, me një hapësirë prej 650 m² dhe hyrje të veçantë, ofron mundësinë ideale për të relaksuar trupin dhe shpirtin, duke u larguar nga rutina e përditshme. Ajo është një mundësi e shkëlqyer për të pasur një stil jetese më aktive, ndërkohë që gjithashtu ofron një ambient të qetë dhe të freskët për t'u çlodhur. Imagjinoni një moment, ashtu si në filmat tuaj të preferuar, ku personazhet e lënë pas stresin dhe gjejnë paqe duke notuar. Tani, ky moment mund të bëhet pjesë e jetës suaj të përditshme.





Sauna

Në Haré Residence, sauna është e krijuar për t'ju ofruar një përvojë të paharrueshme pas një dite të ngarkuar. Kjo hapësirë moderne dhe elegante ofron mundësinë për ta relaksuar dhe rigjeneruar trupin dhe mendjen në një ambient të ngrohtë dhe të rehatshëm. Me teknologji të përparuar dhe një dizajn minimalist, sauna është e pajisur me çdo detaj për t'ju ofruar vetëm relaks.



Palestra

Nëse jeni një adhurues i aktivitetit fizik ose thjesht kërkonit një mënyrë për t'u relaksuar dhe ndjerë më energjik, palestra jonë e pajisur me teknologji moderne është vendi ideal për ju. E hapur çdo ditë, ajo ofron mundësi për ushtrime të ndryshme, nga kardio tek stërvitje me peshë, duke u përshtatur me nevojat e çdo përdoruesi. Me mjedis të pastër, ajër të freskët dhe pajisje të avancuara, do të keni gjithçka që ju nevojitet për të arritur qëllimet tuaja sa i përket shëndetit dhe mirëqenies.

Hapësirë për joga

Këtu, në këtë hapësirë të qetë dhe të harmonizuar, do të keni mundësinë të praktikoni joga në një ambient të përshtatshëm dhe relaksues. Hapësirat e bollshme dhe atmosfera e qetë janë ideale për t'u lidhur me trupin dhe mendjen, duke krijuar një përvojë të thellë dhe përmbushëse. Angazhimi në joga do t'ju ndihmojë të rifitoni energji, të përmirësoni fleksibilitetin dhe të arrini një ekuilibër të plotë mes mendjes dhe trupit.







Furra

Kush nuk e do një kroasant të ngrohtë ose një ushqim të shpejtë gjatë ditës, veçanërisht kur keni nevojë për një pauzë të shijshme? A ka ndodhur ndonjëherë që nuk e dini çfarë të hani dhe dëshironi diçka të shijshme dhe të lehtë për të plotësuar nevojat tuaja të momentit? Furra moderne brenda kompleksit është zgjidhja perfekte për këto momente! Ajo ofron mundësinë për të shijuar produkte të freskëta dhe të pjekura çdo ditë, duke përfshirë bukën e ngrohtë që mbush shtëpinë me aromë, dhe një gamë të gjerë produktesh të tjera të pjekura, të përgatitura me përkushtim.

Marketi

Ndonjëherë, ndjesia e frustrimit kur e kupton që të mungon një produkt esencial dhe duhet të udhëtosh në distanca të largëta vetëm për ta gjetur ky është shqetësim i panevojshëm. Por tani, ky është një shqetësim i panevojshëm! Ky kompleks ofron dyqane të cilat kanë të gjitha produktet që mund t'ju duhen në jetën e përditshme. Kjo mundësi e shkëlqyer ju ofron një nivel komoditeti të paparë, duke ju kursyer kohë dhe mundim, për ta bërë jetën tuaj më të lehtë dhe më të rehatshme.





hare-ks.com / +383 48 887 000

